



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PROJEKTEVE, POLITIKAVE, STRATEGJIVE NË FUSHËN E DREJTËSISË DHE E INTEGRIMIT EVROPIAN

# Newsletter

MAJ 2023

## EVENTE PUBLIKE

### Mbahet takimi i Zyrarëve të Lartë BE- Ballkani Perëndimor për Drejtësinë dhe Punët e Brendshme në Bruksel

Në datën 15 Maj 2023 në Bruksel u mbajt takimi i Zyrarëve të Lartë BE – Ballkani Perëndimor për Drejtësinë dhe Punët e Brendshme.

Në këtë takim përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë raportuan në lidhje me vijueshmërinë e zbatimeve të rekomandimeve të fokusuara mbi krimin e organizuar dhe korrupsionin, zhvillimet më të fundit në bashkëpunimin mes autoriteteve shqiptare Eurojust dhe Zyrën e Prokurorit Publik Evropian si dhe nxitjen e eficiencës dhe përmirësimit të aksesit në drejtësi përmes fuqizimit të ndërmjetësimit dhe instrumentave alternative për zgjidhjen e konflikteve. [Për më shumë.](#)



### Takimi i Komitetit Drejtues Sektorial për Reformën në Drejtësi

Në datën 31 Maj 2023, në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë u zhvillua takimi i Komitetit Drejtues Sektorial për Reformën në Drejtësi, me praninë e partnerëve ndërkombëtarë të cilët kanë bashkëshoqëruar jetësimin e Reformës në Drejtësi, institucioneve të pavarura të drejtësisë, shoqërisë civile, si dhe nën asistencën e çmuar të projektit JustAL. Qëllimi i takimit ishte diskutimi gjetjeve të Raportit të Monitorimit të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe Planit të saj të Veprimit për vitin 2022, qartësimin të asistencës së partnerëve ndërkombëtar në sistemin e drejtësisë. [Për më shumë.](#)

## NDËRGJEGJËSIMI

### Mbahet tryeza e pestë e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian

Në vijim të procesit të negociatave, në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë, u zhvillua tryeza e rradhës në kuadër të Platformës së Partneritetit për Integrim Evropian. Takimi u drejtua nga Zëvendësministria e Drejtësisë, njëkohësisht dhe Negociatore për Kapitullin 23 dhe Kriterin Politik, znj Adea Pirdeni.

Tematika e kësaj tryeze konsistoi në njohjen e anëtarëve të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian me zhvillimet e fundit në kuadër të hartimit të udhërrëfyesve për Shtetin e së Drejtës dhe për Funkcionimin e Institucioneve Demokratike të cilët janë dokumente udhëzuese politike për vitet në vazhdim që Shqipëria do t'i paraqesë Komisionit Evropian për të vijuar procesin e negociatave. [Për më shumë.](#)



### Hartimi i draft udhërrëfyesve për Shtetin e së Drejtës dhe Funkcionimi i Institucioneve Demokratike

Në zbatim të Urdhit të Kryeministrit nr. 57 datë 24.04.2023 "Për disa shtesa në urdhrin nr. 94 datë 20.05.2019 të Kryeministrit "Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e GNPIE", në përputhje me të cilin struktura përgjegjëse për integrimin në Ministrinë e Drejtësisë do të luajë rolin e sekretariatit teknik për këto dy grupe pune, më datë 2-4 maj në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë u zhvilluan takime me institucionet përgjegjëse për hartimin e udhërrëfyesit për Funkcionimin e Institucioneve Demokratike. [Për më shumë.](#)

## RISI

### Takim koordinues për prezantimin e platformës elektronike për raportimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar

Me rastin e ditës së Evropës, në datën 9 Maj pranë Ministrisë së Drejtësisë në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit dhe Kryenegociatorin u organizua takimi informues mbi Platformën e re Elektronike për mbajtjen dhe raportimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Gjatë këtij takimi, institucionet raportuese u informuan mbi Platformën e re Elektronike, e cila do të shërbejë për të mbledhur të dhëna dhe raportuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të plotë në kuadër të procesit të integritimit evropian, mbi historikun e veprave penale të krimit të organizuar, korrupsionit, trafikimit dhe qenieve njerëzore, terrorizmit etj. [Për më shumë.](#)



## WORKSHOPE & TRAJNIME



### Seminar mbi Strategjinë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planin e Veprimit 2023–2025

Në datat 19 dhe 22 Maj, u mbajt seminari mbi Strategjinë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planin e Veprimit 2023–2025. Në këtë takim, i cili u organizua nga Misioni "Terre des hommes" Shqipëri, morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë si dhe institucionet e saj të varësisë, si struktura përgjegjëse për zbatimin e një sërë masash, të parashikuara në këtë Plan Veprimi. [Për më shumë.](#)

### Takimi i parë i Grupit Ndërinstitucional të Punës, për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030

Në datën 12 Maj 2023, Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë zhvilloi takimin e parë me Grupin Ndërinstitucional të Punës në kuadër të hartimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030. Hartimi i këtij dokumenti strategjik vjen si kërkesë e procesit të anëtarësimit në BE, përafritim të legjislativimit me acquis të BE-së dhe garantimit të plotë të të drejtave të viktimave në Shqipëri. [Për më shumë.](#)



<https://web.facebook.com/drejtesia.gov.al>



[https://www.instagram.com/ministria\\_drejtetise/](https://www.instagram.com/ministria_drejtetise/)

<https://www.drejtesia.gov.al>